



Nr. 12720/1, Prot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës

Sh. 2012 20

V E N D I M

Nr. 611, datë 20.10.2020

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONËN E
DËMTUAR PIKËSORE, PËR 6 BANESA KOLEKTIVE, BASHKIA Durrës”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Nr. 45, datë 20.08.2020,

VENDOSA:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore, për 6 banesa Kolektive, Bashkia Durrës, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtëm:
 - a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore;
 - b) Materiali hartografik.
2. Miratohet rindërtimi në Zonë e dëmtuar pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore, me qëllim rindërtimin e objekteve të cilat referuar akt-ekspertizës së thelluar dhe opionencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore, për 6 banesa Kolektive, në Regjistrin

Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.

4. Plani i Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore, për 6 banesa Kolektive të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”*, të ndryshuar.
5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

EMIRIANA SAKO

